

VENDIM
Nr. 907, datë 12.12.2012

**PËR NXITJEN E INVESTIMEVE PRIVATE NË SEKTORIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE DHE PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 27, DATË 19.1.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË VLERËSIMIT DHE
TË DHËNIES SË KONCESIONEVE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 34/1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjekti i furnizimit të energjisë elektrike dhe/ose operatori i sistemit të shpërndarjes, në bazë të kërkesës së prodhuesit të energjisë elektrike, detyrohet të blejë energjinë elektrike të prodhuar, sipas nevojave të blerësit, në bazë të kontratës së shitblerjes të negociuar dhe për të cilën është rënë dakord ndërmjet palëve.

Kur blerësi është shoqëri me kapital 100% shtetëror, çmimi i blerjes do të jetë sa çmimi i importit të energjisë elektrike ditën e blerjes së energjisë, nëse ka, pa përfshirë tarifën e transmetimit ndërkufitar. Nëse nuk ka blerje, çmimi i energjisë do të jetë çmimi, me të cilin ky subjekt ka realizuar blerjen e fundit.

2. Marrëveshjet në fuqi ndërmjet prodhuesve të energjisë elektrike dhe KESH, sh.a. e/ose operatorit të sistemit të shpërndarjes, në të cilat parashikohet miratimi nga Enti Rregullator i Energjisë i çmimit të shitblerjes së energjisë elektrike apo detyrimi i KESH sh.a., sipas vendimit nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar, mbeten në fuqi për aq kohë sa prodhuesit e energjisë elektrike dhe KESH sh.a., nuk bien dakord të ndryshojnë marrëveshjen ekzistuese.

3. Në pikën 1 të kreut IV të vendimit nr. 27, datë 19.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, të ndryshuar, bëhet këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë fjalët “... me fuqi të instaluar deri në 15 MW ...” shfuqizohen.

b) Paragrafi i tretë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Për koncesionet e hidrocentraleve, kontrata përfshin kushtet e përgjithshme dhe të veçanta për shitblerjen e energjisë elektrike. Kur e kërkon koncesionari, subjekti i furnizimit të energjisë elektrike, për pjesën e energjisë elektrike për të cilën është rënë dakord ndërmjet palëve për t’u blerë me çmim të rregulluar, detyrohet ta blejë energjinë elektrike të prodhuar sipas çmimit të përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë. Çmimi i shitjes së energjisë do të jetë i njëjtë për të gjithë koncesionarët dhe do të llogaritet nga Enti Rregullator i Energjisë e do të shpallet prej tij në fillim të çdo viti, në bazë të formulës së mëposhtme.”.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha